



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

22.06.2024

“Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar”

ALTERNATIVA (18 x 1 pikë)

1. Cili është objektivi kryesor i raportimit financiar sipas Kuadrit Konceptual të SNRFsë?

- a) Për të ofruar informacion mbi pozicionin financiar të një entiteti
- b) Për të ofruar informacion mbi performancën financiare të një entiteti
- c) Për të ofruar informacion të dobishëm për investitorët ekzistues dhe potencialë, huadhënësit dhe kreditorët e tjerë
- ç) Për të ofruar informacion për qëllime tatimore
- d) Per te ofruar informacion ne lidhje me ekonomine

Përgjigja e saktë është alternativa C

2. Cila nga më poshtë përshkruan më mirë ‘paraqitjen me besnikëri’ sipas Kuadrit Konceptual të SNRFsë?

- a) Informacioni që është i plotë, neutral dhe i lirë nga gabimet
- b) Informacioni që është i përshtatshëm dhe krahasueshëm
- c) Informacioni që është relevant dhe i verifikueshëm
- ç) Informacioni që është i kuptueshëm dhe konsistent
- d) Informacioni gjithëpërfshires

Përgjigja e saktë është alternativa A

3. Cila nga më poshtë konsiderohet një karakteristikë cilësore shtesë sipas SNRFve që e rrit dobishmërinë e informacionit financiar?

- a) Rëndësia
- b) Paraqitja me besnikëri
- c) Verifikueshmëria
- ç) Vazhdimësia e aktivitetit
- d) Prezantimi me forme tabelare

Përgjigja e saktë është alternativa C

4. Cili është qëllimi kryesor i SKK 01?

- a) Për të përcaktuar bazën për paraqitjen e pasqyrave financiare të përgjithshme
- b) Për të ofruar udhëzime për raportimin specifik të industrisë
- c) Për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret tatimore lokale
- ç) Për të vendosur rregulla për auditimet e pasqyrave financiare
- d) Për të ofruar informacion financiar dhe kontabël për ortakët e shoqërive financiare

Përgjigja e saktë është alternativa A

5. Çfarë thotë Kuadri Konceptual për parimin e kujdesit?

- a) Është një karakteristikë cilësore e nevojshme
- b) Është një konsideratë brenda paraqitjes me besnikëri
- c) Duhet të aplikohet për të mbivlerësuar aktivet dhe të ardhurat apo nënvlerësuar detyrimet dhe shpenzimet
- ç) Nuk është më e rëndësishme në raportimin financiar
- d) Asnje mesiper

Përgjigja e saktë është alternativa A

6. Cilët elementë të pasqyrave financiare nga lista e mëposhtme janë aktive afat-shkurtër?

- a) Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara
- b) Franshize
- c) Inventari
- d) Mjetet monetare (arka, banka)
- e) c dhe d

Përgjigja e saktë është alternativa E

7. Analiza e aktivitetit investues së një njësie ekonomike është e rëndësishme sepse;

- a) Aktivet janë elementët më vitalë që disponon njësi ekonomike për të siguruar përfitueshmërinë që ajo ka si objektiv.
- b) Përdorimi i aktiveve të disponon njësi ekonomike, sjell të ardhura që janë të rëndësishme për të siguruar vijëmsinë e aktivitetit të saj.
- c) Paraqet levizjet e investimeve financiare dhe jo-financiare per periudhen raportuese
- ç) Të treja së bashku;
- d) Asnjëra

Përgjigja e saktë është alternativa Ç

8. Sipas SNK 16 Aktive Afatgjate Materiale, si duhet të maten fillimisht aktivet afatgjate materiale?

- a) Me kosto
- b) Me vlerë të drejtë
- c) Me vlerë të realizueshme neto
- ç) Me të gjitha me lart në varësi të gjykimit
- d) Vetem me a) dhe b)

Përgjigja e saktë është alternativa A

9. Sipas SKK 15 Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike cila nga më poshtë nuk është karakteristikë cilësore e informacionit të pasqyrave financiare të mikronjësive:

- a) Besueshmeria
- b) Rëndësia (Materialiteti)
- c) Kuptueshmeria
- d) Qëndrueshmëria në politikat kontabël
- e) Moskompesimi

Përgjigja e saktë është alternativa E

10. Cila nga të mëposhtmet nuk krijon një detyrim konstruktiv:

- a) Praktikat e së kaluarës
- b) Një deklaratë aktuale
- c) Legjislacioni
- d) Politikat e publikuara
- e) Asnje nga me lart

Përgjigja e saktë është alternativa C

11. Cilat jane njësite ekonomike te cilat ligji nr. 25/2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare i detyron te raportojne pagesat që u bëhen institucioneve shtetërore

- a) Njësitë ekonomike të mesme dhe të mëdha
- b) Njësitë ekonomike të mëdha.
- c) Njësitë ekonomike me interes publik.
- d) Njësitë ekonomike të mëdha aktive në industrinë nxjerrëse.
- ç) Asnjëra

Përgjigja e saktë është alternativa D

12. SKK 15 ka ne fushe te zbatimit njesite ekonomite:

- a) Të klasifikuara si mikronjësi sipas ligjit 25/2018
- b) Që realizojnë të ardhura jo më pak se 5 milion lekë dhe jo më shumë se 30 milion
- c) Që realizojnë të ardhura jo më shume se 5 milion lekë
- ç) Asnje me lart
- d) Te gjitha me lart (a, b dhe c)

Përgjigja e saktë është alternativa A

13. Cilat nga ngjarjet e mëposhtme mund të shkaktojë probleme të menjëhershme në flukset e mjeteve monetare;

- a) Inventari “Produkte të Gatshme” i konstatuar -Skarco; shtyrja e afatit të arkëtimit të llogarive të arkëtueshme; lehtësimi i kushteve të kreditimit nga furnitorët.
- b) Rritja e gjendjes së produkteve të gatshme në magazinë; ulja e gjendjes së deftesave të pagueshme; ulja e afatit të pagimit të detyrimeve ndaj furnitorëve.

- c) Inventar me qarkullim të ngadaltë; llogari të arkëtueshme të dyshimta; ashpërsimi i kushteve të shitjeve me kredi.
- d) Inventari i nxjerrë jashtë përdorimit; rritja në llogaritë e arkëtueshme; lehtësimi i kredive të dhëna nga furnitorët.
- e) Asnje nga me lart

Përgjigja e saktë është alternativa B

14. Njësitë ekonomike, subjekt i ligjit 25/2018, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese

- a) Ekzistencën e inventarit
- b) Vlerësimin e instrumentave financiare
- c) Kapitalin e papaguar
- ç) Ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve
- d) Asnje me lart.

Përgjigja e saktë është alternativa Ç

15. Në shënimet shpjeguese për njësitë ekonomike të mesme, të mëdha dhe ato me interes publik ligji nr. 25/2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare kërkon që të paraqiten specifikisht:

- a) Pagat e anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse.
- b) Numrin mesatar të punëmarrësve gjatë periudhës raportuese.
- c) Emrin dhe selinë
- ç) Tarifat e audituesit ligjor për periudhën raportuese
- d) Te gjitha me lart

Përgjigja e saktë është alternativa D

16. Burimet kryesore të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimi per tu paraqitur sipas SKK 2 përfshijnë:

- a) Arkëtimet e mjeteve monetare nga shitja
- b) Pagesat e mjete monetare për mallra dhe shërbime
- c) Pagesat e mjete monetare për punonjësit
- ç) Arkëtimet dhe pagesat nga investimet, kreditë dhe kontratat e tjera që kanë të bëjnë ose të mbajtura për qëllime tregtare
- d) Te gjitha më lart.

Përgjigja e saktë është alternativa D

17. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit SKK 8, Të ardhurat mbështetet në SNK dhe/ose SNRF si me poshtë:

- a) SNK 11,
- b) SNK 18,
- c) SNRF 15,
- ç) a dhe b,
- d) Te gjitha më lart (a, b dhe c).

Përgjigja e saktë është alternativa Ç

18. Një njësi ekonomike qe zbaton SKK 10 i njeh grantet ne te ardhura si vijon:

- a) Kur granti është arkëtuar nese nuk imponon kushte të specifikuara,
- b) Kur kushtet e performancës te grantit janë plotësuar
- c) Kur njihet si një detyrim
- ç) a ose b
- d) a, b dhe c.

Përgjigja e saktë është alternativa Ç

PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)

Pyetje 1: Përshkruaj strukturën dhe rendin e shënimeve shpjeguese të sugjeruar sipas SKK 2?

Përgjigje:

Struktura e shënimeve të pasqyrave financiare duhet të përmbajë:

- Informacione aktuale në lidhje me bazën e përgatitjes së Pasqyrave Financiare dhe politikave specifike kontabël të përdorura;
- informacione shpjeguese të kërkuar nga SKK, të cilat nuk janë dhënë në Pasqyrave Financiare; dhe
- informacione të tjera që nuk janë paraqitur në Pasqyrat Financiare, por që janë të nevojshëm për të kuptuar elemente të Pasqyrave Financiare.

Një njësi ekonomike normalisht i paraqet shënimet sipas rendit të mëposhtëm:

- një deklaratë që Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK-te
- një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël të zbatuara
- informacion mbështetës për zërat e paraqitur në Pasqyrat Financiare, në rendin në të cilin paraqitet cdo pasqyrë dhe cdo zë apo element i tyre
- shënime të tjera shpjeguese

Pyetje 2: Përse është e rëndësishme dhe detyruese dhënia e informacioneve shpjeguese mbi palët e lidhura. Cilat janë informacionet shpjeguese që duhen dhënë në pasqyrat financiare në rastet kur ka transaksione midis palëve të lidhura në përputhje me kërkesat e SNK 24.

Përgjigje:

Marrëdhëniet e palëve të lidhura janë një tipar normal i tregtisë dhe biznesit. Për shembull njësitë ekonomike zakonisht realizojnë pjesë të veprimtarive të tyre nëpërmjet filialeve, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjeve. Në këto kushte, aftësia e njësisë ekonomike për të ndikuar politikave financiare dhe të shfrytëzimit të investitorëve është nëpërmjet pranisë së kontrollit, kontrollit të përbashkët apo influencës së konsiderueshme. Një marrëdhënie e palëve të lidhura mund të ketë një efekt mbi fitimin apo humbjen dhe pozitën financiare të një njësie ekonomike.

Dhënia e informacioneve shpjeguese është e rëndësishme pikërisht sepse palët e lidhura mund të hyjnë në transaksione të tilla që palët e palidhura nuk mundën. Gjithashtu, transaksionet midis palëve të lidhura mund të mos bëhen me të njëjtat shuma si midis palëve të palidhura. Për shembull, një njësi ekonomike që shet mallra me një kosto të caktuar për shoqërinë mëmë mund të mos ia shesë me këto terma një konsumatori tjetër. Për këtë arsye, lexuesi i pasqyrave financiare duhet të ketë informacion shterues mbi natyrën dhe volumi e këtyre marrëdhënieve.

Nëse ka pasur transaksione midis palëve të lidhura, një njësi ekonomike do të japë informacione shpesh për natyrën e marrëdhënies së palëve të lidhura po ashtu dhe informacion rreth këtyre transaksioneve dhe pasqyrave të pozicionit financiar të papaguara të nevojshme për një kuptim të ndikimit të mundshëm të marrëdhënies mbi pasqyrat financiare.

Si minimum, deklarimet duhet të përfshijnë:

(a) shumën e transaksioneve;

(b) shuma e balancave të papaguara përfshirë angazhimet dhe: (i) termat dhe kushtet e tyre, përfshirë nëse ato janë të sigurta, dhe natyrën e arsytimit për t'u dhënë në shlyerje; dhe (ii) detaje të çdo garancie të dhënë apo të marrë;

(c) provizione për borxhe të dyshimta lidhur me shumën e balancave të papaguara; dhe

(d) shpenzimi i njohur gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija dhe të dyshimta që rrjedhin nga palët e lidhura.

Pyetje 3: Cilat njësi ekonomike e kanë detyrim përgatitjen e raportit ecurisë së veprimtarisë, cilat janë të përjashtuara nga përgatitja e tij, kur dorëzohet dhe çfarë duhet që minimalisht raporti i ecurisë së veprimtarisë të përmbajë?

Përgjigje:

Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, përgatitin raportin e ecurisë së veprimtarisë, i cili, nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse, paraqet në mënyrë të drejtë zhvillimin dhe performancën e njësisë ekonomike, shoqëruar me një përshkrim të risqeve dhe pasigurive kryesore, me të cilat njësia mund të përballlet. (1 pikë)

Me qëllim paraqitjen sa më të kuptueshme të zhvillimit, performancës dhe pozicionit të njësisë, raporti duhet të përmbajë treguesit kryesorë të performancës financiare dhe, nëse është e mundur, jofinanciare, të lidhur me aktivitetin, duke përfshirë informacion për çështjet e mjedisit dhe punonjësve. Analiza duhet, kur është e mundur, të përfshijë referenca dhe shpjegime shtesë për shumat e raportuara në pasqyrat financiare të periudhës raportuese. (1 pikë)

Raporti i ecurisë së veprimtarisë duhet të tregojë gjithashtu edhe: a) zhvillimet e mundshme, të ardhshme, të njësisë ekonomike; b) aktivitetet në fushën e kërkimit dhe zhvillimit; c) informacionet që kanë të bëjnë me marrjen e aksioneve të veta; ç) ekzistencën e degëve të njësisë ekonomike; d) për përdorimin e instrumenteve financiare nga ana e njësisë ekonomike dhe kur është materiale për vlerësimin e aktiveve, detyrimeve, pozicionit financiar, fitimit dhe humbjes. (1 pikë)

Përjashtohen nga detyrimi për përgatitjen e raportit të ecurisë së veprimtarisë:

a) mikronjësitë;

b) njësitë e vogla ekonomike;

c) njësitë ekonomike jofitimprurëse, për të cilat shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare nuk tejkalon vlerën 30 milionë lekë.

Pyetje 4: Kur njihet një zhvlerësim për aktivet afatgjata materiale sipas SKK 5? Si matet vlera e rikuperueshme e një Aktivi Afatgjate Material sipas SKK 5?

Përgjigje:

Nëse vlera kontabile e një aktivi kalon vlerën e tij reale, e cila matet duke gjetur “vlerën e rikuperueshme”, aktivi gjykohet që ka pësuar një zhvlerësim. Si rrjedhim, duhet që vlera e tij të reduktohet me vlerën (apo humbjen) nga kjo rënie në vlere (zhvlerësim).

Vlera e rikuperueshme e një aktivi matet si vlera më e madhe mes:

- a) Vlerës së drejte minus kostot e shitjes; dhe
- b) Vlerës në përdorim.

Pyetje 5: Përshkruaj metodën e interesit efektiv për matjen e instrumentave financiare.

Përgjigje:

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse.

Norma e interesit efektiv është norma që i skonton ekzaktësisht pagesat ose arkëtimet e e ardhshme përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose, kur është e përshtatshme, përgjatë një periudhe më të shkurtër, tek vlera kontabël e aktivit financiar ose detyrimit financiar.

Norma e interesit efektiv përcaktohet mbi bazën e vlerës kontabël të aktivit financiar ose detyrimit financiar në momentin e njohjes. Sipas metodës së interesit efektiv:

- (a) kosto e amortizuar e një aktivi (detyrimi) financiar është vlera aktuale e arkëtimeve (pagesave) të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv, dhe
- (b) shpenzimet (të ardhurat) e interesit në një periudhë të caktuar janë baraz me vlerën kontabël të detyrimit (aktivit) financiar në fillim të periudhës shumëzuar me normën e interesit efektiv për periudhën.

Pyetje 6: Cili është trajtimi kontabël në njohje, matje fillestare dhe matje të mëtejshme për aktivet e mbajtur për investim sipas SNK 40 duke analizuar vështirësitë dhe kompleksitetet që mund të dalin nga praktika krahasueshmërisht midis dy qasjeve të kostos dhe vlerës së drejtë.

Përgjigje:

Ky Standard do të zbatohet në njohjen, matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivin afatgjatë material të investuar.

Njohja dhe matja fillestare

Aktivitet e mbajtura për investim njihen si të tilla kur ato janë të mbajtura për të fituar të ardhura nga qiraja, për rritjen e vlerës së kapitalit, ose për të dyja qëllimet.

Aktivitet afatgjatë material i investuar do të njihet si një aktiv kur, dhe vetëm kur:

- a) buron nga ngjarje të kaluara, dhe njësia ekonomike ka kontroll efektiv mbi aktivin;
- b) ka probabilitet që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin afatgjatë material të investuar do të merren nga njësia ekonomike; dhe

c) kostoja e aktivitet afatgjatë material të investuar mund të matet me besueshmëri

Aktivitet afatgjatë material i investuar matet fillimisht me koston e tij. Në matjen fillestare do të përfshihen dhe kostot e transaksionit. Kostoja e një aktivitet afatgjatë material të investuar të blerë përbëhet nga çmimi i blerjes dhe çfarëdo shpenzimi i ngarkueshëm drejtpërdrejt. Në shpenzimet e ngarkueshme drejtpërdrejt përfshihen, për shembull, tarifatat profesionale për shërbimet ligjore, taksat e transferimit të pasurisë dhe kosto transaksioni të tjera.

Matje e mëtejshme

Pas njohjes fillestare, SNK 40 lejon dy qasje për matjen e mëtejshme të aktiveve të mbajtura për investim: qasjen e koston dhe qasjen e vlerës së drejtë.

Qasja e vlerës së drejtë

Ky Standard kërkon që të gjitha njësitë ekonomike të matin vlerën e drejtë të aktivitet afatgjatë material për investim, si për qëllime të matjes (nëse njësitë ekonomike përdor modelin e vlerës së drejtë) ose për dhënie të informacioneve shpjeguese (nëse ajo përdor modelin e koston).

Një njësi ekonomike inkurajohet, por nuk kërkohet, të matë vlerën e drejtë të aktivitet afatgjatë material për investim në bazë të një vlerësimi nga ana e një vlerësuesi të pavarur, i cili ka një kualifikim të njohur dhe përkatës profesional dhe ka përvojë aktuale në vendndodhjen dhe kategorinë e aktivitet afatgjatë material për investim që po vlerësohet. Aktivitet maten me vlerën e tyre të drejtë, dhe çdo ndryshim në vlerën e drejtë njihet në fitimin ose humbjen e periudhës. Nuk kërkohet amortizim, dhe matja me vlerën e drejtë reflekton më mirë kushtet e tregut.

Qasja e Koston në pamundësi të qasjes me vlerën e drejtë

Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike që zgjedh modelin e koston duhet të masë aktivitet afatgjatë material të investuar:

(a) në përputhje me SNRF 5 Aktivitet afatgjatë që mbahen për t'u shitur dhe operacionet jo të vijueshme kur ato janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose janë përfshirë në një grup për nxjerrje nga përdorimi që është klasifikuar si i mbajtur për shitje);

(b) në përputhje me SNRF 16, nëse ai mbahet nga një qiramarrës si një aktivitet me të drejtë përdorimi dhe nuk mbahet për shitje në përputhje me SNRF 5; dhe

(c) në përputhje me kërkesat në SNK 16 për modelin e koston në të gjitha rastet e tjera, duke e zvogëluar me amortizimin dhe zhvlerësimin e periudhës dhe duke raportuar vlerën kontabël neto të aktivitet.

Njësitë ekonomike duhet të japë shënime shpjeguese për vlerën e drejtë të aktiveve të mbajtura për investim edhe nëse ndjek qasjen e koston. Një aktivitet afatgjatë material i investuar do të rregjistrohet (hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar) kur del jashtë përdorimit ose kur ky aktivitet tërhiqet përfundimisht nga përdorimi dhe nuk pritet të ketë përfitime ekonomike të ardhshme nga nxjerrja jashtë përdorimit të tij. Fitimet ose humbjet neto që rrjedhin nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivitet afatgjatë material të investuar do të përcaktohen si diferencë midis shumës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivitet dhe vlerës kontabël (neto) të tij dhe do të njihet në fitim ose humbje (përveç rastit kur SNRF 16 kërkon trajtim të ndryshëm për shitjen dhe marrjen me qira) në periudhën e vjetërsimit ose nxjerrjes jashtë përdorimit.

Vështirësitë dhe Kompleksitetet

a) Matja e Saktë e Vlerës së Drejtë mund të jetë sfiduese, veçanërisht kur nuk ka treg të qartë për aktivitet. Sidomos në kushtet e Shqipërisë, kur profesioni i vlerësimit të aktiveve është i rregulluar me ligj, kjo kërkon përdorimin e vlerësimeve të ekspertëve, që do të thotë më shumë kosto. Gjithashtu, vlerësimi mund të ketë edhe elemente subjektive. Kostoja e angazhimit të ekspertëve për vlerësim mund të jetë e lartë dhe kërkon kohë.

b) Në qasjen e vlerës së drejtë, vlerat e drejta mund të ndryshojnë shpesh për shkak të luhatjeve të tregut. Kjo mund të shkaktojë pasiguri dhe variabilitet në pasqyrat financiare.

c) Për disa njësi ekonomike, veçanërisht ato me pak burime kontabël, mbajtja e përditësuar e vlerës së drejtë mund të jetë e ndërlikuar dhe kërkon njohuri të specializuara.

ç) Shënime shpjeguese shtesë në lidhje me politikat e matjes, ndjeshmërinë ndaj vlerësimeve të ndryshme

dhe informacione të tjera relevante që mund të rrisin ngarkesën administrative.

d) Transferimet nga aktive të mbajtura sipas një standardi tjetër psh SNK 2, SNK 16 etj në aktive të mbajtura për investim sipas SNK 40, mund të kërkojë gjykim të rëndësishëm dhe mund të lindin probleme praktike nga riklasifikimi që kërkojnë njohuri të thelluara raportuese.

Pyetje 7: Shpjegoni se cilat janë 3 analizat që përdoren për të kuptuar rëndësinë e të dhënave në pasqyrat financiare të një njësie ekonomike dhe shtjelloni shkurtimisht secilën prej tyre.

Përgjigje:

1. Analiza horizontale vlerëson një seri të dhënash të pasqyrave financiare mbi një periudhe kohore
2. Analiza vertikale vlerëson të dhënat e pasqyrave financiare duke shprehur çdo ze/llogari në një pasqyre financiare si përqindje të një shume ose vlere bazë.
3. Analiza e raporteve (ratios) shpreh marrëdhënien midis zerave/llogarive të perzgjedhura te te dhenave te pasqyrave financiare.

USHTRIME (secili nga 6 pike)

Ushtrimi 1 (6 pikë)

Aulona SHPK blen një makineri më 1 maj 2022, për 20,000,000 lekë. Makina kishte një jetë të pritshme të përdorimit prej 5 vitesh dhe një vlerë të mbetur prej 1,000,000 lekë. Aulona ka gjykuar që metoda e lineare reflekton më mirë përfitimet e pritshme ekonomike të makinerisë së blerë. Më 31 dhjetor 2025, makina u shit për 4,000,000 lekë. Aulona shpk harton pasqyrat financiare mbi bazen e SNRF.

Kërkohet:

- Llogarisni shpenzimet e amortizimit për 2022, 2023, 2024 dhe 2025 (3 pikë)
- Bëni regjistrimin kontabël të shitjes së makinerisë në 31 dhjetor 2025, duke dhënë shënimet shpjeguese përkatëse mbi kërkesat e SNK 16 (2 pikë)
- Shpjegoni konceptin e vlerësimit kontabël duke e ilustruar me rastin e Aulona SHPK, për të cilën ka 3 vlerësime kontabël që manaxhimi i Aulonës i ka kryer duke konsideruar të kaluarën, mjedisin ekonomik dhe rrethana të tjera specifike (1 pikë)

Përgjigje:

A:

Amortizimi sipas metodës lineare do të llogaritet si vijon:

(Kosto Historike e Plotë – Vlerë e Mbetur)/Jetë të dobishme = $(20,000,000 - 1,000,000) / 5 = 3,800,000$ në vit.

Për vitin 2022, amortizimi nuk do të jetë për një vit, por në përputhje me kohën nga blerja deri në raportim, konkretisht nga 1 maji që është blerë deri në 31 dhjetor, në total 8 muaj. Për këtë arsye, amortizimi për 2022 do të jetë $3,800,000 \text{ lekë} / 12 * 8 = 2,533,334$ lekë.

Ndërkohë që amortizimi në 2023, 2024 dhe 2025 do të jetë i plotë, pasi është metoda lineare dhe amortizimi nuk ndryshon, përveç vetëm nëse do të kishte rishikime të vlerësimeve kontabël në përputhje me SNK 8. Për këtë arsye, amortizimi për secilin vit do të jetë 3,800,000 lekë respektivisht.

Amortizimi i akumuluar në 31.12.2025 do të jetë 13,933,334 lekë.

b) Bëni regjistrimin kontabël të shitjes së makinerisë në 31 dhjetor 2025, duke dhënë shënimet shpjeguese përkatëse mbi kërkesat e SNK 16 (2 pikë)

B:

Përpara se të bëjmë regjistrimin kontabël duhet që të llogarisim vlerën kontabël neto, që në rastin tonë do të jetë $20,000,000 \text{ lekë} - 13,933,334 \text{ lekë} = 6,066,667$ lekë.

Regjistrimi kontabël:

Amortizimi i vitit 2025 datë 31.12.2025

Debi: Shpenzim amortizimi makineri 3,800,000 lekë

Kredi: Amortizim i akumuluar makineri 3,800,000 lekë

Regjistrimi i amortizimit për vitin për makinerinë

Shitja e aktivitetit datë 31.12.2025 – diferenca midis vlerës kontabël neto dhe vlerës së shitjes sipas SNK 16 do të riciklohet si fitim/humbje nga shitja e makinerisë në PASH

Debi: Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre 4,000,000 lekë

Debi: Amortizimi akumuluar makineri 13,933,334 lekë

Debi: Humbja nga shitja e makinerisë 2,066,667 lekë

Kredi: AAM Makineri 20,000,000 lekë

Regjistrimi i shitjes së makinerisë

Shënimet shpjeguese:

Në pasqyrat financiare do të jepet informacion shpjegues për çdo kategori të aktiveve afatgjata materiale, përfshirë makinerinë:

(a) bazat e matjes të përdoruar për përcaktimin e vlerës kontabël bruto;

(b) metodat e përdorura të amortizimit;

(c) jetët e dobishme ose normat e amortizimit të përdorura;

(d) vlerën kontabël bruto dhe çdo amortizim të akumuluar (të mbledhur me humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi) në fillim dhe në fund të periudhës; dhe

(e) rakordimin e vlerës kontabël (neto) në fillim dhe në fund të periudhës duke treguar qartësisht shitjen, dhe më tej shumën përkatëse të shitjes dhe diferencën që ka rezultuar si fitim/humbje nga shitja e makinerisë.

C:

Vlerësimet kontabël janë shumat monetare në pasqyrat financiare të cilat janë subjekt i pasigurisë në Matje. Një politikë kontabël mund të kërkojë që zërat në pasqyrat financiare të maten në një mënyrë që përfshin pasiguri në matje—kjo do të thotë që politika kontabël mund të kërkojë që zëra të tillë të maten me shumën monetare që nuk mund të vrojtohen drejtpërdrejt dhe prandaj duhet të vlerësohen. Në një rast të tillë njësia ekonomike zhvillon një vlerësim kontabël për të arritur objektivin e përcaktuar nga politika kontabël. Zhvillimi i vlerësimeve kontabël përfshin përdorimin e gjykimeve ose të supozimeve të bazuara në informacionin më të fundit të disponueshëm dhe të besueshëm.

Një njësi ekonomike mund të ketë nevojë të ndryshojë një vlerësim kontabël mund të ketë nevojë të rishikohet nëse ndodhin ndryshime në rrethanat në të cilat ishte bazuar vlerësimi kontabël apo si rezultat i informacionit të ri, zhvillimeve të reja apo eksperiencës. Nga natyra e tij, rishikimi i një vlerësimi nuk lidhet me periudhat paraardhëse dhe nuk është korrigjim i një gabimi. Ndryshimet në vlerësimet kontabël aplikohen gjithmonë në prospektivë, përveç nëse një standard ka kërkesa specifike.

Në përputhje me SNK 8, manaxhimi i Aulonës, do të duhet që të bëjë vlerësime kontabël për minimalisht:

1. Jetën e dobishme që pritet që makineria të gjenerojë përfitime të ardhshme ekonomike

2. Vlerën e mbetur të makinerisë në fund të jetës së dobishme

3. Metodën e amortizimit që reflekton më mirë parimin e përputhshmërisë midis momentin se kur përgjatë jetës së dobishme makineria do të gjenerojë përfitime ekonomike dhe përputhjen me njohjen përkatëse të shpenzimit të amortizimit. Pra, shpërndarjen sistematike të kostos së aktivitetit si shpenzim periudhë në përputhje me kohën se kur këto përfitime ekonomike do të gjenerohen.

Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi do të rishikohet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparshme, ndryshimet do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8 Politikën kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.

Ushtrimi 2 (6 pikë)

Një njësi ekonomike kultivon gjethe duhani. Njësia ekonomike zotëron 2 ton gjethe duhani të korrura (gjethe të padëmtuara) dhe 0.4 ton gjethe duhani të korrura të dëmtuara (gjethe me kërcell të prerë). Në datën e korrjes çmimi i tregut të gjetheve të korrura të padëmtuara ishte 3 lekë për kilogram. Nuk ka çmim tregu për gjethet me kërcell të prerë. Por, njësi ekonomike, vazhdimisht, për disa vjet, e ka negociuar çmimin e gjetheve me kërcell të prerë më 40 për qind të çmimit të tregut për gjethet e padëmtuara. Njësia ekonomike pret të negociojë të njëjtën marrëveshje si në vitet e mëparshme. Kostot e vlerësuara të shitjes (p.sh. taksat e duhanit) si në fletët e padëmtuara ashtu edhe në ato me kërcell të prerë janë 5 për qind e çmimit të transaksionit.

Duke qenë se nuk ka çmim tregu për gjethet me kërcell të prerë, njësi ekonomike e mat vlerën e tyre të drejtë duke rregulluar çmimin e tregut të gjetheve të padëmtuara. **Llogarisni vlerën e drejtë të gjetheve të duhanit të korrura të dëmtuara, sipas SKK?**

Përgjigje:

Duke qenë se nuk ka çmim tregu për gjethet me kërcell të prerë, njësi ekonomike e mat vlerën e tyre të drejtë duke rregulluar çmimin e tregut të gjetheve të padëmtuara (3 lekë për kilogram) për të pasqyruar dallimet mes artikujve të ngjashëm (d.m.th. një ulje prej 60 për qind). Si rrjedhim, në datën e korrjes vlera e drejtë minus kostot e shitjes së duhanit me gjethe të prera (prodhim bujqësor) është 456 lekë. Llogaritja: a. Vlera e drejtë: 400 kg gjethe të prera \times 1.2 lekë çmimi i tregut i rregulluar (d.m.th. 3 lekë për kg çmimi i tregut për aktive të ngjashme \times 0.4 për të pasqyruar diferencat) = 480 lekë.

b. Kostot e shitjes: 5% e 480 lekë = 24 lekë.

c. Vlera e drejtë minus kostot e shitjes: 480 lekë vlera e drejtë minus 24 lekë kostot e shitjes = 456 lekë.

Ushtrimi 3 (6 pikë)

Njësitë ekonomike E dhe F bien dakord të kombinojnë operacionet e tyre dhe të formojnë njësinë ekonomike G. Të gjitha aksionet me të drejtë vote të njësive ekonomike E dhe F shkëmbehen me aksione në njësinë ekonomike G. Vlera e drejtë e njësisë ekonomike E është C510; Vlera e drejtë e njësisë ekonomike F është C490. Aksionarët e çdo njësie ekonomike ruajnë të njëjtat të drejta votimi në njësinë e kombinuar. Aksionerët e njësisë ekonomike E zotërojnë 51% të të drejtave të votës në njësinë ekonomike G dhe aksionerët e njësisë ekonomike F zotërojnë 49%.

Bordi drejtues i njësisë G ka tetë anëtarë, katër prej të cilëve emërohen nga aksionerët e njësisë ekonomike E dhe katër nga aksionerët e njësisë ekonomike F. Të gjitha vendimet kryesore kërkojnë miratimin e 55% të aksionarëve. Palët kanë rënë dakord që aksionerët e njësisë ekonomike F do të kenë të drejtën të emërojnë CEO dhe CFO të njësisë ekonomike G.

Analizoni faktet më sipër dhe identifikoni njësinë ekonomike blerëse sipas SKK 9.

Përgjigje:

Ky është një kombinim biznesi midis njësive ekonomike E dhe F. Njësia ekonomike G nuk mund të identifikohet si blerësi, sepse është një njësi ekonomike e re e krijuar për të emetuar aksione për të realizuar kombinimin e biznesit.

Blerësi është njësia ekonomike ekzistuese e kombinuar që merr kontrollin e njësive ekonomike ose operacioneve të tjera të kombinuara.

Të gjitha vendimet kyçe kërkojnë miratim 55%, kështu që as subjekti E dhe as njësia F nuk kanë kontroll si rezultat i të drejtave të tyre përkatëse të votës. Megjithatë, kontrolli mund të merret me mënyra të ndryshme nga shumica e të drejtave të votës.

Një blerës mund të identifikohet nëse një nga palët në një kombinim biznesi është në gjendje të mbizotërojë në përzgjedhjen e drejtimit të njësisë ekonomike të kombinuar. Njësia ekonomike F do të dominojë emërimet e menaxhimit kyc të kombinimit, duke sugjeruar që njësia ekonomike F ka dominuar përzgjedhjen dhe është blerësi.

Ushtrimi 4 (6 pikë)

Një njësi ekonomike, ishte duke analizuar politikat e arkëtimeve dhe pagesave për vitin 2023, por po kuptonte se dicka nuk shkonte në lidhje me treguesit që ajo po llogariste dhe gjendjes faktike në lidhje me to. Ajo kontraktoi një profesionist kontabël, për ti realizuar shërbimin e analizës së politikave të arkëtim -pagesave. Profesionisti kontabël nxorri të dhënat nga pasqyrat financiare si vijoj:

Emërtimi	Vlera 2022 (ALL)	Vlera 2023 (ALL)
Llogari të arkëtueshme (vlera Bruto)	5 235 000	3 560 000
Kthime nga klientët	850 000	560 000
Zbritje nga klientët	184 700	76 800
Shpenzime për borxh të keq	423 500	125 000
Llogari të pagueshme	8 150 000	8 900 000
Kthime te furnitorë	0	0
Zbritje nga furnitorët	150 000	42 000
Të ardhurat nga shitja neto	21 223 000	15 125 000
Kostoja e mallrave të shitur	13 534 000	9 987 000

Kërkohet të evidentoni treguesit që ka evidentuar profesionisti kontabël, në raportin e përgatitur, si dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës. Tregoni se cilat janë çështjet që duhet të mbahen në konsideratë gjatë llogaritjes së treguesve të evidentuar në raport.

Përgjigje:

Treguesit e llogaritur në raport;

1. Qarkullimi i Llogarive të arkëtueshme = Shitjet neto me kredi / Llogari të arkëtueshme mesatare neto

$$= \frac{15125000}{(5235000-850000-184700-423500)+(3560000-560000-76800-125000)} = 4.6 \text{ Herë}$$

2. Periudha Mesatare e arkëtimeve të Llogarive të arkëtueshme = 365/QLLA

$$= 365/4.6 = 79.58 \text{ ditë}$$

3. Qarkullimi i Llogarive të pagueshme = KMSH / Llogarive të pagueshme mesatare neto

$$= \frac{9987000}{(8150000-150000)+(8900000-42000)} = 1.2 \text{ Herë}$$

4. Periudha mesatare e pagesave për llogaritë e pagueshme = 365/Q.LLP

$$= 365/1.2 = 305 \text{ ditë}$$

Gjatë analizës së politikave të arkëtimeve, parimi i kujdesit nënkupton se profesionisti kontabël duhet të mbajë në konsideratë analizën e Kthimeve nga Klientët, Zbritjet nga klientët, shpenzimet për borxhin e keq,

analiza e prirjes së këtyre treguesve ndër vite, dhe kujdesi që të ardhurat nga shitjet neto duhet të ketë atë pjesë të të ardhurave që njësia ekonomike e ka realizuar bazuar në politikën e Shitjes me Kredi (pra jo Shitjet me para në dorë).

Gjatë analizës së politikave të pagesave, parimi i kujdesit nënkupton se profesionisti kontabël duhet të mbajë në konsideratë treguesin e Kostot së Mallrave të shitur (dhe jo blerjet neto), analizën e Kthimeve nga furnitorët, Zbritjet nga furnitorët dhe analizën e prirjes së këtyre treguesve ndër vite.

Profesionisti kontabël gjatë analizës së kryer duhet të ketë në kujdes interpretimin e treguesve që reezultojnë nga raportet e llogaritura, kjo sepse një raport në rritje nga një vit në tjetrin, jo domosdoshmërisht është tregues i përmirësimit të situatave, psh nëse kemi një rritje të treguesit të shpenzimeve për borxhe të këqija, kjo sjell rritjen e treguesit të qarkullimit të LL.A dhe kjo nuk duhet të interpretohet si përmirësim i situatës, por të analizohen me kujdes faktorët që kanë cuar në arsyen pse klientët nuk shlyejnë detyrimin e tyre ndaj njësisë ekonomike.

Ushtrimi 5 (6 pikë)

Të dhënat e njësisë Tuzi sh.a. dhe filialit të saj Nilu sh.a. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 jepen si më poshtë:

Të dhënat janë në '000 \$

	Tuzi sh.a.	Nilu sh.p.k
Të ardhurat nga shitja	500,200	355,000
Kosto e mallrave të shitur	(249,000)	(185,600)
Fitimi bruto nga shitja	251,200	169,400
Shpenzimet administrative	(123,400)	(104,600)
Të ardhurat nga investimi	300,000	-
Fitimi para tatimit	427,800	64,800
Tatimi mbi fitimin	(22,000)	(7,600)
Fitimi pas tatimit	405,800	57,200

Gjithashtu jepet informacioni si më poshtë:

Tuzi pati investuar në njësinë Nilu sh.a. në 1 janar 2021 duke blerë 80% të kuotave për një vlerë monetare prej \$200 milion. Më 1 korrik 2023 Tuzi e shiti të gjithë pjesëmarrjen në Nilu sh.a. për një vlerë \$300 milion (siç paraqitet në kategorinë të ardhura nga investimi). Kjo shitje përmbush kushtet për klasifikim si një operacion jo i vijueshëm.

Në datën e blerjes dhe më 31 dhjetor 2023, kapitali aksionar i Nilu sh.a. ishte \$ 30 milion ndërsa fitimet e akumuluar në ato data ishin respektivisht \$ 130 milion dhe \$ 203 milion.

Tuzi ndjek politikën e njohjes së interesave jo-kontrollues me metodën e vlerës së drejtë. Në 1 janar 2021 vlera e drejtë e interesave jo-kontrolluese në Nilu sh.a. ishte \$ 46 milion.

Gjatë 3-vjecarit 2021 – 2023, pati vetëm një zhvlerësim të emrit të mirë nga blerja e Nilu sh.a. për një vlerë prej \$ 2 milion në vitin 2022. Në vitet e tjera nuk pati zhvlerësim të emrit të mirë.

Nëse dihet se të ardhurat dhe kostot e operacioneve të Nilu sh.a. janë të shpërndara njëtrajtësisht përgjatë vitit financiar, kërkohet:

Llogarisni, duke argumentuar llogaritjet tuaja, fitimin apo humbjen nga shitja e filialit Nilu sh.a.

Përgjigje:

Për të llogaritur fitimin, apo humbjen nga shitja e Nilu sh.p.k duhen ndjekur disa hapa.

Së pari, duhet llogaritur fitimi i filialit që nga data e fillimit të vitit financiar 1.1.2023 e deri në datën e shitjes, pra 1.7.2023. Meqënëse dihet se të ardhurat dhe kostot e operacioneve të Nilu sh.a. janë të shpërndara njëtrajtësisht përgjatë vitit financiar, atëherë, fitimi për 6 muaj do të jetë:

$$6 / 12 \text{ muaj} * \text{USD } 57.2 \text{ milion} = 28,600 \text{ mijë USD}$$

Më tej vijojmë me llogaritjen e fitimit nga shitja e filialit:

Fitimi nga shitja e filialit	Në mijë USD	Në mijë USD
Të ardhurat nga shitja dhe interesat jo-kontrolluese		
<i>Të ardhurat nga shitja</i>		300,000
<i>Interesat jo-kontrolluese</i>		
Vlera e drejtë në datën e blerjes	46,000	
Pjesa që i takon nga fitimet e pashpërndara të viteve të kaluara: (20% * [USD 203 mln – USD 57.2 mln – USD 130 mln])	3,160	
Pjesa që i takon nga rënia e vlerës së emrit të mirë (20% * USD 2 mln)	(400)	
Pjesa që i takon nga fitimi i periudhës (20% * USD 28.6 mln)	5,720	
Vlera e mbartur më 1 korrik 2023		54,480
TOTAL A - Të ardhurat nga shitja dhe interesat jo-kontrolluese		354,480
Aktivet e filialit që shiten		
Aktivet neto (USD 30 mln + [USD 203 mln – USD 28.6 mln])		204,400
Llogaritja e emrit të mirë		
Vlera e paguar për blerjen	200,000	
Vlera e Interesave jo-kontrolluese në datën e blerjes	46,000	
Aktivet neto (USD 30 mln + USD 130 mln)	(160,000)	
<u>Emri i mire në datën e blerjes</u>	86,000	
Rënia e vlerës së emrit të mirë	(2,000)	
		84,000
TOTAL B - Aktivet e filialit që shiten		288,400
Fitimi nga shitja e filialit (A-B)		66,080

Fitimi nga shitja e filialit është 66,080,000 USD.

Ushtrimi 6 (6 pikë)

Shoqëria Epson përdor sistemin e kostos së prodhimit të vazhdueshëm, metoda mesatare e ponderuar. Të dhënat e mëposhtme janë shkëputur nga librat kontabël të njësisë ekonomike dhe pasqyrojnë operacionet e prodhimit gjatë muajit Janar:

Kostot e prodhimit (mije leke)

Prodhimi në proces në fillim të periudhës:

Kostoja e transfereuar nga reparti i parë	50 000
Materiale	35 000
Punë	25 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit	10 000

Kostot e kryera gjatë muajit:

Kostoja e transfereuar nga reparti i parë	200 000
Materiale	100 000
Punë	85 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit	55 000

Raporti i prodhimit

Njësitë

Prodhimi në proces, në fillim të periudhës,.....	5 000
<i>Asnjë material dhe 40% i perfunduar per PD&SHPP</i>	
Të përfunduara dhe të transferuara në magazinë gjatë muajit.....	15 000
Prodhimi në proces, në fund të periudhës.	2 000
<i>Asnjë material dhe 50% i përfunduar për PD&SHPP</i>	

Kërkohet të përgatisni një raport të kostove të prodhimit për muajin Janar.

Përgjigje:

1. Identifikimi i kostove për tu analizuar

Kostoja e Prodhimi në proces gjendje në fillim të periudhës: 120 000

Kostoja e transfereuar nga reparti i parë	50 000
Materiale	35 000
Punë	25 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit	10 000

Kostot e kryera gjatë muajit Janar *440 000*

Kostoja e transfereuar nga reparti i parë	200 000
Materiale	100 000
Punë	85 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit	55 000

Kostoja totale për tu analizuar dhe shpërndarë *560 000*

2. Përcaktimi i Njësive ekuivalente

	<i>MD</i>	<i>PD dhe SHPP</i>
Të përfunduara dhe të transferuara	$15\,000 \cdot 100\% = 15\,000$	$15\,000 \cdot 100\% = 15\,000$
Prodhimi në proces gjendje në fund	$2\,000 \cdot 0\% = 0$	$2\,000 \cdot 50\% = 1\,000$
Totali i njësive Ekuivalente	15 000	16 000

Përcaktimi i kostot totale të prodhimit për njësi ekuivalente

$$MD = (35\,000 + 100\,000) / 15\,000 = 9$$

$$PD = (25\,000 + 85\,000) / 16\,000 = 6.875$$

$$SHPP = (10\,000 + 55\,000) / 16\,000 = 4.0625$$

Kostoja totale e prodhimit për njësi ekuivalente = 19.9375

Kostoja totale e prodhimit e mbartur nga Reparti i Parë = $(50\,000 + 200\,000) / (5\,000 + 12\,000^*) = 14.706$

*Njësi të transferuara nga reparti i parë gjatë periudhës = $15\,000 + 2000 - 5000 = 12000$

3. Përcaktimi i koston totale të prodhimit të inventarëve

a) Kostoja totale e prodhimit të "Përfunduar dhe transferuar në magazinë" është 519 650 L për 15 000 njësi

- Kostoja totale e prodhimit në repartin e parë = $15\,000 * 14.706 = 220\,588.235\,L$

- Kostoja totale e prodhimit në repartin e dytë = $15\,000 * 19.9375 = 299\,062.5\,L$

b) Kostoja totale e prodhimit të "Prodhimi në proces gjendje në fund periudhe" është 40350 L për 2 000 njësi

- Kostoja totale e prodhimit në repartin e parë = $2000 * 14.706 = 29\,412\,L$

- Kostoja e prodhimit në repartin e dytë është 10 938 L e detajuar si vijon;

- MD = $0 * 9 = 0\,L$

- PD = $1000 * 6.875 = 6\,875\,L$

- SHPP = $1000 * 4.0625 = 4\,063\,L$

Kostoja totale e prodhimit gjatë periudhës është 460 000 Lekë (519 650 L + 40 350 L)

Ushtrimi 7 (6 pikë)

Më 1 shtator 2020, Shoqëria AB bleu një kompani më të vogël që operon në të njëjtën linjë biznesi. Në bilancin e shoqërisë përfshihej një projekt kërkimi dhe zhvillimi në proces i cili premonte rezultate shumë pozitive dhe ishte në pritje të një aprovimi nga Qeveria. Projekti përfshihej me një vlerë kontabël neto \$3 milion në datën e blerjes ndërkohë që aktivet neto të kompanisë vlerësoheshin me \$12 milion pa përfshirë projektin në fjalë. AB pagoi \$18 milion për 100% aksione dhe projekti i kërkim zhvillimit u vlerësua \$5 milion në atë datë nga konsulentët e kompanisë. U fitua edhe miratimi i Qeverisë dhe kjo rriti vlerën e projektit në \$8 milion në fund të vitit.

Shpjegoni se si duhen trajtuar çështjet e mësipërme në pasqyrat financiare të shoqërisë, sipas SKK, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Përgjigje:

Emri i mirë përlogaritet si ndryshimi midis vlerës së drejtë të pageses dhe vlerës së drejtë të aktiveve neto në datën e blerjes. Vlerës kontabël të aktiveve neto duhet tu shtohet vlera e drejtë e projektit në datën e blerjes.

Vlera e drejtë e projektit matet në datën e blerjes, jo në fund të vitit dhe rrjedhimisht ajo nuk vlerësohet me \$8 milion por me \$5 milion. Projekti do të amortizohet përgjatë jetës së dobishme të pritur të produktit të zhvilluar kur produkti të jetë i vlefshëm për shitje ose prodhim

Çmimi i blerjes	18
Aktive neto (me përjashtim të projektit)	12
Projekti	5
Emri i mirë (mbetje)	1

Ushtrimi 8 (6 pikë)

Aplikimi i SNRF 16 per Albanian Capital SHA

Me datë 1 janar 2023, Albanian Capital SHA hyri në një marrëveshje qiraje për hapësirë zyre për pesë vite. Pagesat e qirasë vjetore janë 5,000,000 lekë, të paguara në fillim të çdo viti. Vlera e drejtë e pronës nuk është e përcaktueshme lehtë, dhe norma inkrementale e kredive (IBR) sipas Bankës së Shqipërisë është 6%. Shoqëria ka parapaguar një muaj qira.

Gjithashtu, në datë 1 prill 2023, Albanian Capital SHA hyri në një marrëveshje qiraje për hapësirë zyre në një tjetër vendndodhje për dhjetë muaj. Pagesat totale të qirasë për periudhën janë 200,000 lekë, të paguara në fillim të qirasë. Vlera e drejtë e pronës nuk është e përcaktueshme lehtë, dhe norma inkrementale e kredive është 7% sipas Bankës së Shqipërisë .

Kërkohet:

a) Llogarisni për kontratën e parë të qirasë, vlerën e aktivit me të drejtën e përdorimit dhe detyrimin e qirasë në 1 janar 2023 dhe 31 dhjetor 2023. Bëni regjistrimet kontabël në 1 janar dhe 31 dhjetor respektivisht për të gjithë zërat që preken duke ilustruar llogaritjen e shumave përkatëse bashkë me sqarimet përkatëse. (4 pikë)

b) Bëni regjistrimet kontabël për kontratën e dytë në datë 1 prill, në njohje dhe matje fillestare dhe në 31 dhjetor respektivisht për të gjithë zërat që preken duke ilustruar llogaritjen e shumave përkatëse bashkë me sqarimet përkatëse. (2 pikë)

Përgjigje:

Në datën e fillimit qiramarrësi do ta masë detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të, pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat e qirasë do të skontoohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi duhet të përdorë normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit. Në rastin tonë, do të merret norma IBR nga Banka e Shqipërisë. Mund të gjykohet edhe për ta axhustuar normën IBR në rritje, duke qenë se normat e Bankës së Shqipërisë kanë të përfshirë kolateralin. Në këtë zgjidhje ilustruese nuk është gjykuar që axhustimi është i nevojshëm.

Llogaritja gjithmonë fillon nga detyrimi i qirasë që duhet ndarë në afatshkurtër për shumën që është e pagueshme për 12 muaj, dhe në afatgjatë për pjesën tjetër. Detyrimi i qirasë në matjen fillestare do të llogaritet duke diskontuar me normën IBR të gjithë fluket e pritshme të pagesave, pa përfshirë parapagimin që do të shtojë në aktivin me të drejtë përdorimi. Në vitin e fundit, kësti vjetor nuk do të jetë i plotë 5,000,000 lekë, por për 11 muaj, që sipas llogaritjeve do të jetë:

Detyrimi i qirasë:

$$=5,000,000/(1+0.06)^1 + 5,000,000/(1+0.06)^2 + 5,000,000/(1+0.06)^3 + 5,000,000/(1+0.06)^4 + 4,583,334/(1+0.06)^5 = 20,752,593 \text{ lekë.}$$

Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi në matjen fillestare do të përfshijë:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë si më sipër;
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, minus çdo stimul qiraje të marrë;
- çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për çmontimi dhe lëvizjen e aktivit bazë, restaurimi i vendit në të cilin ishte vendosur ai ose restaurimi i aktivit bazë , në kushtet e kërkuara nga termat dhe kushtet e qirasë.

Konkretisht, aktivi me të drejtë përdorimi në matjen fillestare do të llogaritet i barabartë me detyrimin e qirasë duke i shtuar efektin e parapagimit për muajin e fundit. Për këtë arsye, aktivi me të drejtë përdorimi do të jetë 20,752,593 lekë + 416,667 lekë = 21,169,260 lekë.

Regjistrimi në 1 janar 2023 do të jetë:

Debi: Aktiv me të drejtë përdorimi 21,169,260 lekë.

Kredi: Detyrim për qiranë financiare 20,752,593 lekë. Kredi: Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre 416,667 lekë *Njohja dhe matja fillestare si regjistrim kontabël i kontratës së qirasë*

Pas datës së fillimit, qiramarrësi do të masë aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos. Për të zbatuar modelin e kostos, qiramarrësi duhet të masë aktivin me drejtë përdorimi me kosto: (a) minus ndonjë amortizim të akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi; dhe (b) të rregulluar për ndonjë ri matje të detyrimit të qirasë që në rastin tonë nuk është e aplikueshme. Qiramarrësi duhet të zbatojë kërkesat për amortizim të SNK 16 Toka, ndërtesa, makineri e pajisje kur amortizon aktivin me drejtë përdorimi, përgjatë afati të kontratës së qirasë që në rastin tonë është 5 vite, me metodën lineare.

Amortizimi vjetor = Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi/Afatin e kontratës = 21,169,260 lekë/5 vite = 4,233,852 lekë në vit.

Në lidhje me matjen e mëpasshme e detyrimit të qirasë pas datës së fillimit, një qiramarrës , do të masë detyrimin e qirasë: (a) duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;

(b) duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e bëra të qirasë; dhe (c) duke ri matur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar çdo rivlerësim ose modifikim të qirasë që në rastin tonë nuk është e aplikueshme.

Interesi vjetor për vitin 2023 = 6% (norma e gjykuar IBR) x 20,752,593 lekë (Balanca Fillestare Paraardhëse)

= 1,245,156 lekë për të gjithë vitin 2023.

Pagesat totale për të gjithë vitin 2023 = 5,000,000 lekë. Si pasojë, detyrimi i qirasë në 31 dhjetor 2023 do të jetë: 20,752,593 + 1,245,156 – 5,000,000 = 16,997,749 lekë.

Regjistrimet kontabël në datë 31 dhjetor 2023 do të jenë si vijon:

Debi: Shpenzim amortizimi për aktivin me të drejtë përdorimi 4,233,852 Kredi: Zhvlerësim i akumuluar për aktivin me të drejtë përdorimi 4,233,852

Njohja dhe regjistrimi i amortizimit vjetor

Debi: Shpenzime interesi për qiranë financiare 1,245,156

Kredi: Detyrim për qiranë financiare 1,245,156

Njohja dhe regjistrimi i interesit për QF

Debi: Detyrim për qiranë financiare 5,000,000

Kredi: Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre 5,000,000

Njohja e pagesave të qirasë për të gjithë vitin

Vlerat që do të raportohen në pozicionin financiar do të jenë:

Aktiv me të drejtë përdorimi 16,935,408 lekë

Detyrim për qiranë financiare 16,997,749 lekë

B:

Kontrata e dytë e qirasë nuk është në objektin e SNRF 16 për shkak se ka afat prej 10 muajsh që praktikisht është më e vogël se 12 muaj dhe konsiderohet qira afatshkurtër.

Qiramarrësi mund të zgjedhë të mos i zbatojë kërkesat e SNRF 16 për a) qiratë afatshkurtra; dhe (b) qiratë për të cilin aktivi bazë është me vlerë të ulët.

Nëse një qiramarrësi nuk zgjedh të zbatojë kërkesat e SNRF 16 si ato për qiratë afat-shkurtra ose me qira për të cilin aktivi është me vlerë të ulët, qiramarrësi do të njohë pagesat e qirasë që lidhen me ato qira si një shpenzim në të dyja rastet mbi bazën e drejtë përgjatë afatit të qirasë ose në një tjetër bazë sistematike. Qiramarrësi do të aplikoj një bazë sistematike në qoftë se baza është më përfaqësuese e modelit më të mirë të qiramarrësit.

Për këtë arsye, në këtë rast, qiramarrësi do të njohë cdo muaj si shpenzim pagesën e qirasë, dhe nuk do të krijohen aktive me të drejtë përdorimi apo detyrime për qiranë financiare. Duke qenë se në rastin tonë janë parapaguar të gjitha që në fillim, atëherë do të njihim të drejtën tonë dhe do ta rregullonim cdo muaj:

Në datë 1 prill, njohja e parapagimit për 10 muaj:

Debi: Parapagim qiraje 200,000 lekë

Kredi: Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre 200,000 lekë

Rregullimet në cdo fund të muajit për 10 muaj që është afati i qirasë, përfshirë 30 prillin dhe 31 dhjetorin:

Debi: Shpenzim qiraje 22,223 lekë

Kredi: Parapagim qiraje 22,223 lekë

Ushtrimi 9 (6 pikë)

Një njësi ekonomike lidh një marrëveshje me një palë të tretë sipas së cilës njësi ekonomike ia shet llogaritë e arkëtueshme me një vlerë kontabël prej 19,000,000 lekë (20,000,000 lekë shuma bruto minus 1,000,000 lekë zbritja për borxhin e keq) palës së tretë. Pala e tretë e paguan njësinë ekonomike me 18,000,000 lekë për llogaritë e arkëtueshme. Njësi ekonomike dhe pala e tretë vlerësojnë, mbi bazën e përvojës së njësisë ekonomike, se 19,000,000 lekë nga 20,000,000 lekë llogari të arkëtueshme do të shlyhen (d.m.th. humbjet për borxhin e keq priten të jenë 1,000,000 lekë). Megjithatë, njësi ekonomike nuk e ka garantuar palën e tretë që do të arkëtohet ndonjë shumë e caktuar. Debitorët do të paguajnë njësinë ekonomike dhe kjo e fundit do t'ia kalojë të gjitha arkëtimet palës së tretë. Në fund, për shkak se një klient ishte në proces likuidimi, u paguan vetëm 17,000,000 lekë të llogarive të arkëtueshme. Për këtë arsye njësi ekonomike i kaloi vetëm 17,000,000 lekë palës së tretë.

Si është trajtimi kontabël në përputhje me SKK 3 INSTRUMENTET FINANCIARE? Pasqyro regjistrimet kontabël.

Përgjigje:

Në këtë rast, njësia ekonomike i ka transferuar palës së tretë në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së llogarive të arkëtueshme. Në mënyrë të veçantë pala e tretë ka rrezikun më të madh, i cili është rreziku i kredisë. Por pala e tretë do të kishte përfituar nga ndonjë zhvillim pozitiv (d.m.th. nëse do të ishin paguar plotësisht 20,000,000 lekë të debitorëve pala e tretë do të kishte arkëtuar 20,000,000 lekë). Në përputhje me këtë, njësia ekonomike i heq llogaritë e arkëtueshme prej 19,000,000 lekë nga pasqyra e pozicionit financiar (d.m.th. i çregjistron ato), dhe kjo tregon se nuk ka asnjë detyrim në lidhje me të ardhurat e arkëtuara nga pala e tretë. Njësia ekonomike duhet të njohë një humbje nga shitja prej 1,000,000 lekë e llogaritur si diferenca ndërmjet vlerës kontabël të llogarive të arkëtueshme në kohën e shitjes (d.m.th. 19,000,000) dhe të ardhurave të arkëtuara nga pala e tretë prej 18,000,000 lekë. Regjistrimet për transferimin janë si më poshtë:

D Para (aktiv financiar) 18,000,000 lekë

D Fitim ose humbje— humbje nga shitja e llogarive të arkëtueshme 1,000,000 lekë

K Llogari të arkëtueshme (aktiv financiar) 19,000,000 lekë

Njësia ekonomike njeh një detyrim financiar për të gjitha paratë e arkëtuara nga debitorët që ajo ende nuk ia ka kaluar palës së tretë, shumën 17,000,000 lekë. Regjistrimet do të jenë si më poshtë për arkëtimin e parave:

D Para (aktiv financiar) 17,000,000 lekë

K Shuma e arkëtuar në emër të palës së tretë (detyrim financiar) 17,000,000 lekë

Me arkëtimin e shumës 17,000,000 lekë njësia bën transferimin ndaj palës së tretë, dhe për këtë duhet të bëhen regjistrimet e mëposhtme: D Shuma e arkëtuar në emër të palës së tretë 17,000,000 lekë (detyrim financiar) K Para (aktiv financiar) 17,000,000 lekë